

LULJETA MINE, ARJAN SHUMELI

PËRPUNIMI I TERMINOLOGJISË PYJORE DHE PROBLEME TË NJËSIMIT TË SAJ

Abstrakt

Çdo terminologji e përpunuar si tërësi elementesh të strukturuar, në bazë të koncepteve përkatëse përfshin një informacion të mirëfilltë shkencor si edhe paraqet në mënyrë të kondensuar e të përmbledhur fushën përkatëse të dijes. Të gjithë jemi të bindur se përdorimi i saktë i gjuhës (amtare apo të huaj) është i një rëndësie të madhe, në qoftë se duam t'u përgjigjemi sfidave të globalizimit të botës shkencore, si edhe të sigurojmë një të kuptuar më të mirë të gjuhës teknike të çdo fushë dije, në rastin tonë, të pylltarisë.

Hapja e shoqërisë sonë ndaj tregut të lirë, rritja dhe zhvillimi në çdo fushë, kontaktet me specialistët e huaj, shkëmbimi i eksperiencave, transferimi i të rejave shkencore nga një vend në tjetrin ka sjellë futjen dhe përdorimin e termave dhe koncepteve të reja, të cilat duhet të modifikohen e të rishikohen vazhdimisht. Përveç kësaj, duhet theksuar se disa përkthime të pastandardizuara dhe joprofesionale kërkojnë domosdoshmërisht jo vetëm përpunim të vazhdueshëm të kësaj terminologjie, por edhe rishikimin e fjalorëve ekzistues, terminologjikë, ku përfshihet edhe pylltaria. Gjithashtu, depërtimi dhe ndikimi i huazimeve në terminologjinë pyjore, sigurisht, kërkon standardizim dhe një punë terminologjike të kujdesshme dhe të herëpashershme. Së fundi, globalizimi në ditët e sotme kërkon unifikim të terminologjisë, në mënyrë që të arrihet një komunikim efikas midis specialistëve

Fjalët kyçe: *përpunim, njësim, term, punë terminologjike, koncept, standardizim.*

1. Hyrje

Terminologjia pyjore është zhvilluar e përsosur përmes përpunimit të herëpashershëm të saj. Kjo nënkupton procesin e përpunimit të njërive terminologjike (termave), përsosjen e tyre si nga ana sasiore dhe cilësore. Ai është i lidhur ngushtësisht me saktësinë dhe qartësinë e termave, rregullimin e sistemit të tyre, si edhe me pastrimin e kësaj terminologjie nga huazimet, kur ato janë të panevojshme.

Meqë fusha e pyjeve si fushë dije është në proces zhvillimi, kjo do të thotë që edhe terminologjia pyjore është gjithashtu në proces zhvillimi dhe përpunimi, krahas të gjitha fushave të tjera. Terminologjia dhe menaxhimi (administrimi) profesional i koncepteve dhe termave si në çdo fushë, edhe në

pyje po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Përpunimi i j terminologjisë pyjore e gjen shprehjen apo pasqyrimin e saj në komunikimin midis specialistëve të fushës, në tekstet mësimore, fjalorë, artikuj shkencorë, kumtesa, etj.

Duhet theksuar se përpjekjet për përpunimin e terminologjisë pyjore dhe pasqyrimi në fjalorë e tekste janë të kahershme. Vlen të përmendet I. Mitrushi (Mitrushi I. “Drurët dhe shkurret e Shqipërisë”, 1955) dhe Ll. Treskën (Treska, Ll., “Silvikultura”, 1982, Manuali pyjor 1959) të cilët krijuan një skedë të re termash në bimbësinë pyjore (Dendrologji) dhe pylltari (Silvikulturë) nga përkthimet e tyre nga anglishtja, gjermanishtja, frëngjishtja dhe rusishtja në terminologjinë pyjore shqipe. Për ilustrim po sjellim disa shembuj: “*gjethe e gishtuar, mëllugë; gjethe e rëpuqtë; gjethe leshatake; gjethe pushake; gjethe e shogët*”, “*grumbull pyjorë, mbarështim pyjorë, gëmushajë, lëmishte, imshajë, trungishte*” etj.

Ajo çka vihet re në tekstet e tyre “Drurët dhe shkurret e Shqipërisë” dhe “Manuali Pyjor” është se autorët përdorin mirë rregullat e shqipes përsa i përket fjalëformimit apo shqipërimit të termave, si p.sh. *dru-ja* (e diferencuar, jo si bimë, por si lëndë); *gjethe të kundrejtuar*; *lulerenditja (në vend të infloreshencës)*; *renditje tjegullore*; *rreshtimi i gjetheve (në vend të fitolaksisë)* etj.

Njëkohësisht, I. Mitrushi është një mbledhës i mirë i fjalëve (termave) nga krahina të ndryshme të vendit tonë. Kjo gjë dëshmon se autori është një njohës i mirë i shqipes. P.sh. *hormoq - çetinë e zezë-bren i zi; arnen - artin i bardhë - rrobull i bardhë – arn - mëlikë-mëkish - errlë*, etj.

Kjo punë e admirueshme e këtyre autorëve ka sjellë plotësimin e terminologjisë pyjore në fushën e dendrologjisë dhe silvikulturës, si edhe ka shërbyer si bazë në hartimin e teksteve të tjera të mëvonshme.

2. Dysorët

Gjatë dekadës së fundit janë botuar tekste mësimore pothuajse për çdo lëndë (apo nënfushëz të pyjeve), por jo të shoqëruar me një mini-fjalor në fund të teksteve siç ndodh me ato të huaja. Ky mini-fjalor i shoqëruar me përkufizimet përkatëse për çdo term, ndoshta do të ndihmonte jo vetëm studentët e fushës në fjalë, por më së shumti, si bazë në hartimin e një fjalori të madh për pyjet. Më vonë mund të kalohej në hartimin e fjalorëve për çdo nënfushëz të pyjeve. Gjithashtu, në këto tekst vihet re një nga dukuritë semantike, siç është sinonimia. Ndoshta, jo të gjithë specialistët e kësaj fushe janë ende “të vetëdijshëm” për vlerën dhe dobinë e një shkencë të tillë siç është “terminologjia”, një nga problemet e së cilës është edhe prania në të e sinonimisë absolute, ose të dysorëve. Në të gjitha rastet e mëposhtme (të marra nga disa tekste), dysorët përdoren të dy krahas njëri tjetrit, si:

i. Botanika e Përgjithshme

“Vlera themelore e bimëve lidhet me një tjetër *përmasë/dimension*.” f. 3; duhet *përmasë*.

Përpunimi i terminologjisë pyjore dhe probleme të njësimimit të saj

“... me formimin e trastës embrionale të *pjekur* (të *maturuar*). f. 150; të përdoret vetëm termi shqip të *pjekur*.

ii. Mbrotjtja e Pyjeve nga Zjarri (leksione për studentët)

“...reaksionet *ekzotermike* (të *jashtme*).” f. 7 të përdoret vetëm termi i dytë i shqipëruar, të *jashtme*.

iii. Gjenetika Pyjore

“...në qelizat *somatike* (*trupore*) të llojeve të ndryshme.” f. 16; duhet përdorur termi shqip, *trupore*.

“... janë tërësisht *sterile* (*shterpë*). 117; Të përdoret vetëm termi shqip *shterpë*.

“Procesi i pllenimit ... quhet *inbriding* (*kryqëzim në vetvete*)”, f. 135; Të përdoret *kryqëzim në vetvete*.

“*Nënforma* (*subforma*) ose biotipi është njësia...” f. 144; Të përdoret *Nënforma*

“*Kryqëzimi analizes* (ose *testkros*)” f. 62 Të përdoret vetëm termi shqip

iv. Sistematika e Bimëve me Elemente të Gjeobotanikës

“*Nënlloji* (*subspecia*) është një popullim...” f. 10; të përdoret, *nënlloji*.

“...ose i *disociuar* (i *veçuar*).” f. 42 duhet përdorur termi shqip, i *veçuar*.

“...përveç *farëveshurve* (*angjiospermet*) f. 138; duhet përdorur termi shqip, *farëveshurave*.

Mirëpo, duhet thënë se nganjëherë krijohet mundësia për të zgjedhur termat më të përshtatshëm ndërmjet çifteve dysorë. P.sh. *dekovil pyjor* dhe *hekurudhëz pyjore*, ku duhet të përdoret, kjo e fundit.

Bashkëjetesa e dysorëve e cenon sistemin terminologjik. Në të tilla raste duhet të përdoret termi shqip përderisa ai ekziston. Kjo i shërben edhe pastërtisë së gjuhës. Në këtë rast del e domosdoshme puna me njësimin e terminologjisë, e cila duhet të kryhet në bazë të parimeve dhe kriterëve shkencore terminologjike që lidhen me një varg kërkesash që shtrohen para termave siç janë qartësia, përpikëria, sistemësia etj. Përpunimi dhe njësimi i kësaj terminologjie lidhet me hartimin e fjalorëve. Problemi i vendit që zë terminologjia e pylltarisë në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe nuk është trajtuar asnjëherë deri më sot si çështje më vete. Kjo gjë shpjegohet me faktin që për këtë terminologji nuk ekziston një fjalor i mirëfilltë pyjor.

Një nga problemet në zhvillimin e fjalorëve të pylltarisë është përcaktimi më i saktë i përmbajtjes së kësaj fushe. Në dekadat e mëparshme, *pylli* përshkruhej i lidhur gjerësisht me menaxhimin e lëndës drusore dhe përdorimin e produkteve pyjore. Ndërsa në dy dekadat e fundit, fusha e pylltarisë është zgjeruar duke përfshirë jo vetëm drurët, por edhe përbërës të tillë si tokën, vegjetacionin, jetën e egër, etj. Deri tani nuk janë bërë përpjekje në përcaktimin se në ç’skallë, një fjalor i pylltarisë duhet të përfshijë terma që trajtojnë detaje brenda nënfushave të tilla si *tokat pyjore*, *mbrotjtja e bimëve*, *fiziologjia e drurëve*, *industria e letrës*, etj.

3. Hartimi i fjalorëve

Siç u theksua më lart, përpunimi i kësaj terminologjie lidhet me krijimin e fjalorëve. Sipas Prof. J. Thomait “terminologjia ka mbetur ende në fazën e identifikimit e shqipërimit të njësive terminologjike...është zhvilluar më shumë terminografia, d.m.th. hartimi i fjalorëve terminologjikë shumë gjuhësh, duke iu shmangur hartimit të fjalorëve terminologjikë shpjegues për çdo fushë”¹.

Kjo është e dukshme edhe në fushën e pylltarisë, pasi deri tani nuk ka asnjë fjalor të kësaj fushe në gjuhën shqipe (shqip-shqip, ku të jepen termat së bashku me përkufizimet e tyre) me përjashtim të “Fjalorit të Termave Themelore të Bujqësisë” (2006), në të cilin janë përfshirë një pjesë e termave të pylltarisë, por jo në mënyrë të zgjeruar, pra jo si një fushë e mëvetësuar e dijes. Gjithashtu, në këtë fjalor nuk përfshihen togfjalësja të zgjeruar të cilët janë tregues të shkallës së motivimit të lartë të tyre. Rrallë gjen togfjalësja me më shumë se dy elemente. Ndërsa në fjalorët e tjerë ekzistues të bujqësisë janë përfshirë një pjesë e termave të pylltarisë, të cilat kanë lidhje me bimësinë dhe jo me nënfushat, por jo si një shtresë e mëvetësuar e pylltarisë.

I vetmi fjalor i hartuar për pylltarinë, deri tani është *Fjalorthi i Terminologjisë Pyjore* i hartuar nga prof. M. Kotro, në shqip, anglisht dhe frëngjisht (2000). Ky fjalor është nominal, d.m.th. janë dhënë vetëm emra, por jo folje, mbiemra, (këto jepen vetëm në togfjalësja, pra të shoqëruar me emra) apo ndajfolje. Kështu, p.sh., jepen termat *pyll*, *pyllëzim*, por jo folja *pyllëzoj*, apo mbiemri *i*, *e pyllëzuar*. Ndaj sot, del si domosdoshmëri botimi i fjalorëve terminologjikë pyjor, me terma të shoqëruar me përkufizimet e tyre përkatëse. Për një fjalor të tillë më shumë se kushdo tjetër kanë nevojë specialistët e pyjeve, dhe pse jo edhe studentët që vazhdojnë studimet në këtë degë, specialistët e së ardhmes.

Për të pasur fjalorë sa më të kohës, që t’i përgjigjen kërkesave të ndryshme që shtrohen sot në çdo fushë të ngushtë të dijes, është e domosdoshme që fjalorët e botuar më parë të rishikohen duke u shtuar edhe fondin terminologjik të krijuar deri më sot. “Si kriter themelor për përfshirjen e një termi në fjalor merret roli i tij shoqëror dhe jo rëndësia që ka ai në sistemin e nocioneve të kësaj a asaj dege të shkencës e të teknikës”².

Për ta bërë leksikografinë e specializuar të suksesshme, është e nevojshme që një fjalor jo vetëm të shkruhet nga një gjuhëtar apo një ekspert i një fushë përkatëse, por edhe prej të dyve nga ata, duke formuar një ekip. E njëjta gjë vlen edhe për terminologjinë: këtu një terminolog dhe një specialist duhet të

¹ J. Thomai, *Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe probleme dhe detyra*, Tiranë, 2009, f. 63.

² A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e një fjalori të gjuhës së sotme shqipe*, SF, 1968/2.

Përpunimi i terminologjisë pyjore dhe probleme të njësimimit të saj

punojnë së bashku. Sa më shumë gjuhët të përfshihen aq më i madh duhet të jetë ekipi i punës.

Kjo punë nuk është e lehtë sepse kërkon "nga përpiluesi të njohë mirë fushën përkatëse, kërkon mjete edhe kohë"³. Terminologu mban përgjegjësi për anën gjuhësore të termave, ndërsa specialisti për anën konceptore e sisteme të koncepteve. Ky sistem konceptesh duhet të përbëjë bazën në hartimin e një fjalori terminologjik.

Fjalorë të tillë, mirë do të ishte që të udhëhiqeshin dhe kontrolloheshin nga një bord specialistësh të pyjeve, në bashkëpunim me organizmat ndërkombëtarë që merren me terminologjinë pyjore, sepse ndodh, që në vende të ndryshme, për të njëjtin term të jepen përkufizime të ndryshme. Le të sjellim një shembull: për termin *pyll* ose *tokë pyjore*, sot në botë ekzistojnë 400 përkufizime⁴.

Madje për këtë term, edhe brenda gjuhës shqipe, në fjalorë të ndryshëm terminologjikë jepen përkufizime të ndryshme. Le t'i vërejmë ato në dy fjalorë:

i. **Fjalor i Termave Themelorë të Bujqësisë** (f. 447, 2006), *pyll* "grupim i dendur drurësh që mbulojnë një sipërfaqe të gjerë trualli, që jetojnë në bashkëvarësi të ngushtë me mjedisin dhe që formojnë në këtë mënyrë një bashkësi jetese komplekse, të aftë të ushtrojnë një funksion ekonomik dhe shoqëror të rëndësishëm me prodhimet dhe ndikimet e tij të dobishme"

ii. **Fjalorthi i Terminologjisë Pyjore**, (M. Kotro, f. 45-46, 2000) *pyll*:

a. Në përgjithësi, një ekosistem i karakterizuar nga një mbulesë drurësh, pak a shumë e shtrirë dhe e dendur.

b. Në veçanti, një komunitet bimor i përbërë, kryesisht prej drurësh apo shkurre.

c. Një pjesë territori, administrativisht e kufizuar, e destinuar kryesisht për lëndën e drurit apo të tjera produkte pyjore, ose e mbajtur me veshje drunore, për përfitime indirekte si ato për mbrojtjen e pellgjeve ujore, çlodhje, turizëm, etj.

d. Grupim drurësh në një sipërfaqe të caktuar, që jetojnë në bashkëvarësi me mjedisin rrethues dhe kanë rol të shumëfishtë si ekologjik, ekonomik, social, rekreativ, etj.

e. Sipërfaqe toke, e veshur me drurë e shkurre, të cilët përbëjnë në vetvete një bashkësi jetese komplekse, ose biogeocenozë.

f. Në mbarështimin pyjor, sipërfaqe të veshura me bimësi drunore, jo më e vogël se 0,5 ha.

³ N. Caka, L. Susuri, *Standardizimi dhe normëzimi i terminologjisë shkencore dhe profesionale*, Konferencë shkencore, Durrës, 2009, f. 46.

⁴ IUFRD, Paper 14, 2000.

Në hartimin e fjalorëve të kihet parasysh se çfarë e përbën fushën e pylltarisë, pra jo thjesht menaxhimi dhe prodhimi i lëndës drusore, por të përfshihen të gjitha nënfushat e saj. (sistematika, dendrologji, pedologji, dendrometri, inventarizim, politika pyjore, studim druri, silvikulturë, silvikulturë speciale, mbarështim pyjesh, mbarështim i zonave të mbrojtura, shfrytëzim pyjesh, teleferikë, rrugë pyjore, mekanizim pyjor, ergonomi, mbrojtje pyjesh, marketing, ekonomi pyjore, etj.).

Përveç kësaj, në përpilimin e këtij fjalori, e rëndësishme do të ishte edhe “përcaktimi paraprak i vëllimit tërësor të termave”⁵, pra kjo të mos lihej në fund. Nëse fusim një term të ri duhet të shikojmë nëse krijohet dubletësi. Puna me fjalorët ka të bëjë edhe me shpjegimin e termit. Në përkufizimin e fjalës si term duhen pasur parasysh se termi brenda një fushe të caktuar është i njëkuptimshëm, prandaj dhe përkufizimi i tij duhet të jetë i prerë dhe i qartë. “Termi është emërtimi i saktë, i përpiktë i një nocioni që pasqyron një send, dukuri, cilësi, marrëdhënie, proces dhe dallon nga njësia e leksikut të përgjithshëm pikërisht për këtë saktësi të kufijve kuptimorë”⁶.

Ndaj, në përkufizimin e një termi duhet të jepen tiparet më thelbësore të tij, ndërsa në përkufizimin e një fjalë të leksikut të përgjithshëm mund të jepen edhe karakteristika jothelbësore. Sipas H. Pashos, vëllimi i përkufizimit të termit është më i gjerë, më i hollësishëm, ndërsa i fjalës së zakonshme është më i “rrudhur”. Përkufizimet e termave duhet të jenë të sakta, pa prekur saktësinë e informacionit teknik shkencor që ato bartin.

4. Fjalor i fushës së pyjeve

Fjalorët, që përfshijnë shumë fusha të dijes, nuk mund të japin një pamje të përgjithshme të saktë, të secilës prej tyre, siç ndodh me Fjalorin e termave themelorë të bujqësisë, ku përfshihen edhe teknologjia dhe pylltaria. Kjo mund të kuptohet si një thirrje për ekspertët e fushës së pyjeve dhe terminologëve. Ndërsa, një fjalor që i përket një nënfushe ndoshta do të jetë një fjalor më i mirë se një fjalor që i përket një fushe të vetme, por përsëri ky lloj fjalori ende do të jetë më i plotë se një fjalor që mbulon shumë fusha.

Përdoruesit e fjalorëve janë shpesh të gabuar, kur zgjedhin një fjalor që mbulon një numër maksimal prej fushave të dijes, duke shpresuar që kjo të jetë zgjidhja më e mirë. Ata nuk janë në dijeni të faktit, që fjalorët që përfshijnë shumë fusha të dijes, vështirë se mund të mbulojnë çdo fushë mjaftueshëm. Ekspertët në fushën e leksikografisë së specializuar, të tillë si Bergenholtz, Schaeder dhe Tarp kanë të drejtë në pretendimin e tyre se duhet të ketë një tendencë drejt fjalorëve që janë të nën-fushave. Kjo nevojë mund të

⁵ E. Lafe, *Leksiku terminologjik si problem gjuhësor dhe kombëtar*, “Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe probleme dhe detyra”, Konferencë shkencore, Durrës 2009, f. 57.

⁶ H. Pasho, *Zhvillimi i terminologjisë së ekonomisë pas çlirimit dhe pasqyrimi i saj në dy fjalorët shpjgues të gjuhës shqipe*, SF, 1984/1, f. 54.

Përpunimi i terminologjisë pyjore dhe probleme të njësimimit të saj

mbulohet mjaft mirë nga terminologjia, e cila e “identifikon çdo nënfushë deri tek ndarja më e fundit”⁷. Kjo është detyrë e terminologjisë për të përfaqësuar me kufij të prerë fushat përkatëse të dijes, pasi çdo fushë konsiderohet si një sistem i koncepteve të ndërvarrura. Në vendet e zhvilluara dhe me gjuhë të standardizuara, terminologjia ofron njohuri të thella të një nënfushë të vogël, por në shqip, për fushën në fjalë, ato nuk ekzistojnë, si rezultat, nuk i jep specialistëve, studentëve të pyjeve asnjë mundësi për të zgjedhur fjalorë të këtij lloji.

Sipas Felber puna terminologjike konsiston në: mbledhjen dhe regjistrimin e termave në një fushë të caktuar; gjetjen, krijimin ose standardizimin e një sistemi konceptesh të fushës së caktuar; përcaktimin e konceptit për çdo term; përshkrimi i koncepteve me anë të shpjegimeve apo përkufizimeve si edhe standardizimi i tyre; regjistrimi i të dhënave terminologjike (si termat, përkufizimet, kontekstet në të cilat përdoren, marrëdhëniet konceptuale, barasvlerësit në gjuhë të tjera, së bashku me burimet e këtyre të dhënave dhe informacionet që i shoqërojnë ato)⁸.

Regjistrimi i termave pyjorë në një bankë të vetme të dhënash, do t'i bënte ato të disponueshme, veçanërisht kur ato lidhen me transferimin e njohurive. Është detyrë e specialistëve ta rregullojnë këtë situatë nëpërmjet aktiviteteve sistematike terminologjike në bashkëpunim me gjuhëtarët të cilët s'mund t'i zëvendësojnë ata. Regjistrimi i tyre bën që të ruhen e të përditësohen konceptet. Mirë do të jetë që të ruhen edhe burimet nga merren ato. Përpilimi i një fjalori terminologjik shqip, të fushës së pyjeve, mbi bazën e termave tashmë të ngulitur në përdorim dhe në bazë të kriterëve themelore të hartimit të fjalorëve terminologjikë, dhe shkollës së Wuster-it është detyrë dhe perspektiva e së ardhmes për pasqyrimin e plotë të zhvillimit të kësaj fushe të dijes.

Hartimi i fjalorëve varet edhe nga formimi shkencor dhe gjuhësor i ekspertëve të fushës, në shqipe dhe gjuhë të huaj kur ato janë dy ose më shumë gjuhësh. P.sh. tek “Fjalori i termave themelorë të bujqësisë” vërejmë se disa terma nuk janë përkthyer saktë si *kurorë dendësi* jepet me *crown coverage*. Në fakt duhet *canopy*; *shoqërim pyjor* jepet me *a forest community*, duhet *a forest association*; *prodhime të dyta - accessory products*, duhet *non-wood products*; *ripërtëritje - restoring*, duhet *regeneration*; *grumbull pyjor - forest crop*, duhet *forest stand*; *cungishte - a sprout forest*, duhet *coppice*; *parcelë pyjore - forest compartment*, duhet *forest site*; *gatër - gang mill*, duhet *sawmill*; ose për termin *çlëvorim* jepen dy terma në anglisht: *peeling* dhe *debarking*. Duhet të përdoret vetëm ky i fundit.

⁷ Parathënie, *Fjalor i termave themelorë të bujqësisë*, 2006.

⁸ H. Felber, *Infoterm: Computerized terminology in termnet: the role of terminological data banks*, International Information Centre for Terminology, Vienna, Austria, 1982.

Problemi qëndron në faktin se për terminologjinë pyjore nuk ekziston një punë e organizuar, një planifikim dhe politikë e tillë (*sipas shkollës së Vjenës*) që ta orientojë këtë punë. Kjo punë bëhet në mënyrë individuale (në tekste, kumtesa, artikuj, përkthime, etj.), për të cilën mund të thuhet se përbën një mangësi për këtë terminologji. Përveç kësaj, mund të thuhet se nuk ka një bashkëpunim të vazhdueshëm midis specialistëve të fushës në fjalë dhe terminologëve. Mungon një punë e koordinuar midis specialistëve për grumbullimin e herëpashershëm dhe përditësimin e termave në mënyrë që këto terma t'i përgjigjen shkallës së zhvillimit të pyjeve, pavarësisht se kjo kërkon edhe kushte financiare. Termat e regjistruar duhet të kontrollohen nga një trup specialistësh (ndoshta të ngrihet një komision) në bashkëpunim me organizatat botërore që merren me këtë punë. Bashkëpunimi me terminologjinë ndërkombëtare lehtëson punën e përkthyesve, krijon kooperim në rang botëror, krijon kushte për shkëmbim informacioni dhe së fundi përditëson bankën e të dhënave.

5. Standardizimi

Gjatë punës terminologjike nuk mund të lëmë pa përfshirë standardizimin. Standardizimi nënkupton përcaktimin e koncepteve. Ai është i lidhur edhe me monitorimin e terminologjisë të përkthyer në shqipe, që deri tani nuk mund të thuhet se kryhet në shkallën që kërkohet. Ndaj, mendojmë se terminologjia pyjore është para një sfide të madhe, sfidës së përpunimit dhe standardizimit të saj. Gjithashtu, rritja e polisemisë çon në shterminologjizimin e termave, bëhet pengesë në komunikim. Kjo kërkon domosdoshmërisht standardizimin e terminologjisë pyjore.

6. Konkluzione

Qëllimi i terminologjisë nuk është thjesht komunikimi midis specialistëve, por edhe lehtësimi i këtij komunikimi nga keqkuptimet. Globalizimi në ditët e sotme kërkon unifikim të terminologjisë, në mënyrë që të arrihet një komunikim efikas midis specialistëve. Përpunimi, standardizimi i terminologjisë pyjore vazhdon të jetë një kërkesë për njësimin e saj. Specialistët e pyjeve, stafi pedagogjik në universitet, përkthyesit mund të mbledhin, krijojnë dhe rishikojnë një bankë termash (t'i zgjerojnë me kalimin e kohës). Ky material do të përbëjë një bazë të shëndoshë, të konsoliduar për hartimin e një fjalori për fushën e pyjeve, i cili do të shërbejë si një bazë dijesh në të ardhmen për studentët dhe njëkohësisht do të jetë gur themeli për hartimin e fjalorëve për nënfushat e pyjeve.